




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË



**MIRATIMIN E MËNYRËS SË ORGANIZIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR KRYESITË
DHE KRYETARVE TË FSHATRAVE TË BASHKISË LIBOHOVË**

Mbështetur në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore", neni 32 gërma k, neni 45 pikat 1, 3, dhe 5, neni 46, si dhe bazuar në udhëzimin nr 5789 Prot datë 04.12.2000 të Ministrisë së Pushtetit Lokal "Për zgjedhjen e kryesive dhe kryetarve të fshatrave", Këshilli i Bashkisë Libohovë:

VENDOSI

1. Të miratojë mënyrën e organizimit të zgjedhjeve për kryesitë dhe kryetarët e fshatrave, bashkëlidhur faqja 2.
2. Për zbatimin e vendimit të këshillit ngarkohet Administratori I njesisë që ka në juridiksion fshatin si dhe sekretari i këshillit.
3. Në përfundim të zgjedhjes së kryesive dhe kryetarve të fshatrave të informohet keshilli për përfundimet e arritura.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Prefektura.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Emin BEQARI

Zv. KRYETARI I KËSHILLIT

Jorgji KURÇI



Menyra e organizimit te mbledhjeve.

1. Evidentohet pjesemarrja dhe nese jane prezent mbi 50% e banorve me te drejte vote, vazhdohen procedurat (ne se nuk sigurohet kjo pjesmarrje mbledhja shtyhet per nje date tjeter e cila u komunikohet pjesmarrsve dhe pjeses tjeter te fshatit apo te lagjes).
- 2 . Njeri nga tre antaret e keshillit çel mbledhjen dhe propozon zgjedhjen e presidiumit, si dhe personin qe do te mbaje procesverbalin e mbledhjes.
- 3 .Propozohen kandidaturat, diskutohet rreth tyre dhe votohet , me votim te fshehte.
4. Ne perfundim te votimit shpallen fitues 3(per fshatrat e vegjel) ose 5(per fshatrat e medhenj) antaret me me shume vota.
5. Me mbarimin e mbledhjes se fshatit organizohet mbledhja e pare e gjithë te zgjedhurve te cilet perbejne kryesine e fshatit dhe me votim te fshehte te anetarve te kryesise, zgjidhet kryetari I fshatit. Edhe ne kete mbledhje mbahet procesverbal. Menjehere me zgjedhjen e kryetarit te ri behet dhe dorezimi me procesverbal I detyres nga kryetari I meparshem. Ne procesverbal duhet te fiksohet dorezimi I te gjithë pajisjeve ne inventar dhe vules zyrtare qe ka perdorur kryetari I meparshem (kryeplaku).
6. Procesverbalet e mbajtura ne te gjitha mbledhjet grumbullohen nga sekretari I keshillit dhe ruhen ne arkiven e bashkise.